

KËRKESË
Nr. 4953, datë 28.9.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT
“BEJLERI ALFA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 78/2014, pika “ç”, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative” dhe të nenit 60 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative”, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 17.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet po përballlet në pengesa për mosrealizimin e njoftimeve të akteve administrative ndaj kundërvajtësve në fushën e mjedisit. Këto janë masa administrative, të tilla si: vendime, dënime me gjobë, të cilat duhet të ekzekutohen brenda afateve ligjore nga ana e institucionit tonë, në mënyrë që të mos parashkruhen.

Për këtë arsye, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me qëllim realizimin e objektivave të vendimit të Këshillit të Ministrave, në të cilin citohet dhe shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative nga organi epror, vendimi i të cilit përbën dhe titull ekzekutiv, gjendet përpara përgjegjësisë së ekzekutimit të vendimeve të veta, që nënkupton depozitimin e kërkesës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për nxjerrjen e urdhrave ekzekutivë.

Por, kjo procedurë po pengohet për shkak të mosrealizimit të njoftimit të vendimit të subjekteve kundërvajtës, arsye e së cilës janë adresat jo të sakta nga ana e kundërvajtësve ose shpeshherë dhe të larguar nga vendndodhja e tyre e deklaruar. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar nëpërmjet shërbimit postar apo dhe dërgimit dorazi, në të dyja rastet është kthyer njoftimi i institucionit me konfirmimin nga shërbimi postar: Largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Për sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Mjedisit bën njoftimin paraprak, autorizimin e inspektimit, dërgimin e listës së verifikimit, procesverbalin e inspektimit, vendimin përfundimtar të inspektimit respektivisht për subjektin si më poshtë:

- “Bejleri Alfa” sh.p.k.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Edison Konomi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E INSPEKTIM KONTROLLIT**

Nr. 4180 prot.

Tiranë, më 13.8.2020

Lënda: Njoftim paraprak i autorizimit të inspektimit

“BEJLERI ALFA” SHPK

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, kulla II, kati 12, hyrja 2, Tiranë
Vendndodhja: Fier

Në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenit 32, pika 1, ju njoftojmë për autorizimin e inspektimit me nr. AKM-DQ-2020- 000026-1, çështje, datë 12.8.2020, “Për ushtrimin e inspektimit të subjektit “Bejleri Alfa” sh.p.k., më datë 19.8.2020 deri më 21.8.2020, “Për mbarëvajtjen e inspektimit” kërkojmë nga ana juaj një person kontakti për paraqitjen e dokumentacionit dhe inspektimin në terren. Në rast pengimi të inspektimit, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.
Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Edison Konomi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA QENDRORE
AUTORIZIM INSPEKTIMI**

Nr. AKM-DQ-2020-000026-1

Datë 12.8.2020

Bazuar në nenin 27, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-në për krijimin e inspektoratit shtetëror përkatës, autorizoj inspektimin e

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit

Emri i subjektit: BEJLERI ALFA

NIPT: L32721401P

Adresa/vendndodhja: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, kulla II, kati 12, Hyria 2 Tiranë, TIRANË, Tiranë.

Përshkrim i objektit të inspektimit

Informacion i detyrueshëm periodik

Inspektorët shtetërorë të autorizuar për të kryer inspektimin:

Junid Tahiraj ID: 14000445

Oltjana Telhaj ID:

si dhe persona të tjerë të autorizuar: Kleant Semema

Kohëzgjatja e inspektimit: Tri ditë

19.8.2020, 10:34

12:17

(data e fillimit, ora)

21.8.2020,

(data e përfundimit, ora)

Vendi/vendet ku do të kryhet inspektimi (adresa/t): Bulevardi “Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kulla II, kati 12, hyrja 2, Tiranë, TIRANË, Tiranë). Vendi ku do të ushtrohet inspektimi është në qarkun Fier.

Njoftimi paraprak i autorizimit të subjektit të inspektimit:

Po ☒

Jo ☐

Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet për arsye: Jashtë plani

**KRYEINSPEKTORI
Edison Konomi**

Subjekti:

Subjekti mbyllur:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E INSPEKTIM-KONTROLLIT

Nr. 4180/1 prot.

Tiranë, më 20.8.2020

Lënda: Dërgim të listë së verifikimit dhe të procesverbalit të inspektimit

BEJLERI ALFA SHPK

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, kulla II, kati 12, hyrja 2, Tiranë

Vendndodhja: Fier

Në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 568, datë 17.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, dhe në zbatim të autorizimit të inspektimit me nr. AKM-DQ-2020-000026-1 çështjeje, datë 12.8.2020, “Për inspektimin e operatorit “Bejleri Alfa” sh.p.k., për lejen mjedisore me PN-9730-04-2015, për instalimin “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”, me vendndodhje Portëz, Fier. Bashkëlidhur po ju paraqesim listë-verifikimin me nr. AKM-DQ-2020-000026, datë 20.8.2020 dhe procesverbalin e inspektimit me nr. AKM-DQ-2020-000026-2, datë 20.8.2020.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Edison KONOMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

LISTË VERIFIKIMI
LISTE VERIFIKIMI PËR MJEDISIN

Nr. AKM-D0-2020-000026

Datë 20.8.2020

Qarku: Tiranë

Subjekt i inspektuar për herë të 2-të

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1	Emri i subjektit	BEJLERI ALFA
2	Data e fillimit të aktivitetit	21.3.2013
		Industna minerarc
3	Lloji i aktivitetit ekonomik	Industria minerare
4	Adresa - qendër (rrugë, njësi, telefon)	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, kulla II, kati 12, hyrja 2, Tiranë, TIRANË, Tiranë
5	Adresa të tjera - filiale (rrugë, njësi, telefon)	
6	Përfaqësuesi i subjektit (emri, atësia, mbiemri)	Besim Adulla Mullaj
7	NUIS - QKR (Nr. unik i identifikimit)	L32721401P
8	Tipi i pronësisë	Tipi i subjektit
		Tipi iSubjektit
	Shqiptare (100%)	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara

Nr.	Ligji	Kërkesa	Po	Jo	Komente
1	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 25	A është paguar tarifa vjetore për lejen e mjedisit?			Gjatë inspektimit në terren nuk u paraqit asnjë përfaqësues ligjor apo person i autorizuar për operatorin në fjalë për objektin e inspektimit dhe mbajtjen e procesverbalit të inspektimit Nga komunikimi në rrugë elektronike (e-mail zyrtar) me Sektorin e Buxhetit dhe Financës/Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë AKM-së rezultoi se: Operatori "Bejleri Alfa", me leje mjedisore me PN-9730-04 – 2015, nuk ka kryer pagesat vjetore për periudhën e ushtrimit të veprimtarisë.

Nr.	Ligji	Kërkesa	Po	Jo	Komente
2	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejen e mjedisit", i ndryshuar, neni 29	– objekti?			Nga inspektimi në terren për lejen mjedisore me PN-9730-04-2015, rezultoi se për vendndodhjen e miratuar, nuk ushtrohet aktivitet për instalimin "nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret"
3.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 2 - Menaxhimi i instalimit?			
4.	Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, neni 32/55/58/46	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 2 - Menaxhimi i instalimit?			
5.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar	Raporti vjetor			
6.	Ligji nr. 10448, 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 3 – Operimi dhe infrastruktura?			
7.	Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, neni 43/50	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 3 – Operimi dhe infrastruktura?			
8.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 4 – Plani i përputhshmërisë dhe afatet kohore?			
9.	Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, neni 50/65	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 4 – Plani i përputhshmërisë dhe afatet kohore?			
10.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 5 – Interpretimi?			
11.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 16/29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 6 – Njoftimet?			
12.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 7.1 – Shkarkimet në ajër?			
13.	Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, neni 31/39	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 7.1 – Shkarkimet në ajër?			
14.	Ligji nr. 162/2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në			

	në mjedis”, neni 13/14/15/20	aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 7.1 – Shkarkimet në ajër”			
15.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 7.2 – Shkarkimet në kanalizime?			
16.	Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, neni 23	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 7.2 – Shkarkimet në kanalizime?			
17.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 7.3 – Shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë (përveç shkarkimeve në kanalizime)?			
18.	Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, neni 23	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 7.3 – Shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë (përveç shkarkimeve në kanalizime)?			
19.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 7.4 – Ujërat nëntokësore dhe toka?			
20.	Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 54	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 7.4 – Ujërat nëntokësore dhe toka?			
21.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 8 – Menaxhimi i mbetjeve?			
22.	Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 17/19/21/22/23/24/25/26/27/28/29/30/31/32/33/34/35/36/37/38/39/40/41/42/43/44/45/46/47/48/49 /50/51/53/54/55/57/58/61/62	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 8 – Menaxhimi i mbetjeve?			
23.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 9 – Zhurma dhe vibracionet?			
24.	Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 32	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 9 – Zhurma dhe vibracionet?			
25.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 10 – Lëndët e para dhe shfrytëzimi i energjisë?			
26.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 11 – Monitorimi?			
27.	Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, neni 44	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 11 – Monitorimi?			
28.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 12 – Dokumentimi dhe raportimi?			Nga komunikimi në rrugë elektronike (e-mail/ zyrtar) me Sektorin e Monitorimit/Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, pranë AKM-së, rezultoi se operatori “Bejleri Alfa”, me leje mjedisore me PN-9730-04-2015, nuk ka raportuar për zbatimin e kushteve të miratuara në tabelën 121.1 për përdhën e ushtrimit të veprimtarisë.
29.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 13 – Incidentet dhe			

		veprimet gjatë emergjencave?			
30.	Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, neni 50	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 13 – Incidentet dhe veprimet gjatë emergjencave?			
31.	Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 29	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 14 – Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve?			
32.	Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, neni 50	A janë zbatuar kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit të lejes mjedisore, referuar kushtit 14 – Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve?			

Inspektorët:
Junid Tahiraj
Oltjana Telhaj
Kleant Semema



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA QENDRORE PROCESVERBAL INSPEKTIMI

Nr. AKM-DQ-2020-000026-2

Datë 20.8.2020

Bazuar në nenin 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Par inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: BEJLER1 ALFA, NIPT: L32721401P Adresa/vendndodhja: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Kullat Binjake, kulla II, kati 12, hyrja 2, Tiranë, TIRANË, Tiranë.
Emri i punëdhënësit: Besim Adulla Mulaj

Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektim, 6 (orë).

20.8.2020, 08:20

(data e fillimit, ora)

ora)

20.8.2020, 14:20

(data e përfundimit,

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", kullat binjake, kulla II, kati 12, hyrja 2, Tiranë, TIRANË, Tiranë).

Vendi ku do të ushtrohet inspektimi është në qarkun Fier.

Njoftim paraprak lënë subjektit: Po ☐ Jo ☐

Inspektim me autorizim: Po ☐ Jo ☐

Lloji i autorizimit: Autorizim i afishuar Po ☐ Jo ☐

Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:

Po ☐ Jo ☐

Përfundimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit:

Po ☐ Jo ☐

Arsyetimi i përfundimit:

Nuk ka

Masa urgjente: Po ☐ Jo ☐

II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT

1. Mostra të marra: Po ☐ Jo ☐

Nuk ka.

2. Dokumente të marra:

Nuk ka.

3. Vendim për sekuestrim dokumentacioni:

Nuk ka

4. Detyra të përrealizuara nga inspektimi i mëparshëm:

Nuk ka.

5. Detyrimi i subjektit për paraqitje në zyrën e inspektorit: Po ☐ Jo ☐

6. Dokumentacioni dhe sendet që duhet të paraqisni:

Dokumente të paraqitura:

Nr.	Dokumenti dhe përshkrimi	Nr. i fletëve
1.		

Sende të paraqitura:

Nr.	Sendi dhe përshkrimi	Copë
1.		

Mosparaqitja do të konsiderohet pengim në kryerjen e detyrës së Inspektorit Shtetëror referuar nenit 54, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në RSH”.

7. Gjetjet e konstatuara

Ka shkelje të kërkesave ligjore: Po ☐ Jo ☐

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve.

1. Neni: neni 25., neni 27. Ligji: ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

Pika: pika 3 e nenit 25, pika “b” e nenit 27. Komente: 1. Operatori nuk ka kryer pagesat vjetore për periudhën e ushtrimit të veprimtarisë. 2. Operatori nuk ka raportuar për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore për periudhën e ushtrimit të veprimtarisë.

Bashkëlidhur listëverifikimi për zbatimin e ligjit nr. 76/2014, i plotësuar gjatë inspektimit.

8. Njoftimi i procesverbalit të subjektit të inspektimit

Për faktet dhe rrethanat e konstatuara të paraqitura në këtë procesverbal, subjekti mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet e tij, me shkrim ose me gojë, pranë Inspektoratit Shtetëror, brenda datës së përcaktuar nga ligji.

Me përfundimin e këtij afati do të merret vendim i përfundimtar i inspektimit.

Bashkëlidhur lista e verifikimit të plotësuar gjatë inspektimit.

9. Në rast se nuk konstatohen shkelje të jepen arsyet e përfundimit të procedimit.

Këshillimet

Nuk ka

III. KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, nenit/neneve, neni 48, pika 1, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Paralajmërim.

2. Dënim administrativ plotësues:

Në zbatim të nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, propozojmë pezullim të lejes mjedisore me PN-9730-04-2015.

Shkeljet e kërkesave ligjore për t’u korrigjuar:

-

Bashkëlidhur fleta shoqëruese për këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

Bashkëlidhur dokumente që inspektori i gjykon të nevojshme për procesin e inspektimit.

IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Vendim përfundimtar i veçantë:

Kontestimet e subjektit

Ka kontestime: Po ☐ Jo ☐

V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datë 20.8.2020 dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët shtetëror/ë :

Junid Tahiraj ID: 14000445

Oltjana Telhai ID:

Kleant Semema ID:

Personi i autorizuar nga subjekti

Nuk u paraqit.

Bashkëlidhur listëverifikimi plotësuar gjatë inspektimit.

Procesverbali i njoftohet subjektit brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.

Ky procesverbal mbahet në 3 kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E INSPEKTIM-KONTROLLIT

Nr. 4180/2 prot.

Tiranë, më 10.9.2020

Lënda: Njoftim për dërgim të vendimit përfundimtar të inspektimit.

BEJLERI ALFA SHPK
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, kulla II, Kati 12, hyrja 2, Tiranë
Vendndodhja: Fier

Në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, ligjit nr. 9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 568, datë 17.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, dhe në zbatim të autorizimit të inspektimit me nr. AKM-DQ-2020-000026-1, çështjeje, datë 12.8.2020 për inspektimin e operatorit “Bejleri Alfa” sh.p.k., për lejen mjedisore me PN-9730-04-2015 për instalimin “nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”, me vendndodhje Portëz, Fier.

Bashkëlidhur po ju paraqesim vendimin përfundimtar të inspektimit me nr. AKM-DQ-2020-000026-5, datë 9.9.2020.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Edison Konomi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA QENDRORE
VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. AKM-DQ-2020-000026-5

Datë 9.9.2020

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. AKM-DQ-2020-000026–2, datë 20.8.2020, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “Bejleri Alfa”, NIPT: L32721401P, përfaqësues i autorizuar i subjektit: Nuk u paraqit asnjë përfaqësues apo person i autorizuar për inspektimin edhe pse është njoftuar në rrugë zyrtare, prej datës 19.8.2020, ora 10:34 deri më datën 21.8.2020, ora 12:17.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 20.8.2020, dhe e njoftoi në datën 20.8.2020. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore, ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e midisit”, të ndryshuar, neni 25, neni 27, pika 3 e nenit 25, pika “b” e nenit 27.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10433, neni 48, pika 1, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Paralajmërim.

2. Dënim administrativ plotësues:

- Në zbatim të nenit 29, pika 3 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, propozojmë pezullim të lejes mjedisore me PN-9730-04-2015.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

-

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Kleant Semema

Junid Tahiraj ID: 14000445

Oltjana Telhaj ID:

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “Bejleri Alfa” ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.